



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE RINISË

Nr. 6330 prot.

Himarë, më 07.11.2024

Lënda : Kthim përgjigjeje kërkesës suaj për informacion datë 28.10.2024 .

TOP CHANNEL ALBANIA
(Rruga "17 Nëntori", godina nr.20 Mëzez Kodër, Kashar, Tiranë Shqipëri)

TIRANË

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion dërguar me e-mail në datën 28.10.2024, protokolluar në institucionin tonë me nr. 6330 prot, datë 30.10.2024, për përfshirjen në dokumentarin me në fokus bashkitë për mundësitë që i jepen kategorive në nevojë për sa i përket fondit të alokuar për çdo program si ai social dhe strehimi, Bashkia Himarë për t'iu ardhur në ndihmë individëve në nevojë nëpërmjet hartimit të programeve ku në fokus shërbimet sociale por dhe rehabilitimin e banesave shumë të amorizuara për kategorit më të pafavorizuara, ka parashikuar programe dhe fonde si më poshtë sipas kategorive :

Buxheti vjetor i Bashkisë Himarë për çështjet sociale është 7.500.000 lekë, ky buxhet është i shpërndarë në aktivitete ndërgjegjësuese për vajzat dhe gratë, fëmijët në nevojë si dhe shtresat në nevojë por dhe programe për nxitjen e përfshirjes së tyre dhe fuqizimin e kategorive të ndryshme. Bashkia Himarë vazhdimisht aplikon në thirrje ku në fokus janë individët e pafavorizuar për programe dhe projekte të ndryshme por dhe nga specialistë të çështjeve sociale, arsimit dhe rinisë të cilët aplikojnë në thirrje që institucionet përgjegjëse hapin.

Për vitin 2024 është aplikuar në dy institucione, konkretisht në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për programin e strehimit social dhe në Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë për programin e fondit social. Së fundmi bashkia ka përfituar mbështetjen për bashkëfinancimin në programin e strehimit nga ministria përkatëse ku i ka ardhur në ndihmë disa familjeve në nevojë. Këto projekte hartohen nga një grup pune i ngritur nga titullari për ndjekjen e procesit i cili merr dhe trajnimin e duhur për të gjitha ndryshimet dhe risitë në aplikimet për thirrje. Në territorin e Bashkisë Himarë janë 66 familje që trajtohen

me ndihmë ekonomike si dhe 201 individë të trajtuar me KEMP. Institucioni i mbështet këta persona në lehtësim të procedurave që kanë lidhje me atë duke i përjashtuar nga tarifat për shërbime të ndryshme si dhe duke iu dhënë prioritet në programet nxitëse në sturt upe dhe programe të tjera me në fokus individët në nevojë.

Në sistemin e strehimit dhe në zyrat e pritjes së qytetarëve janë bërë disa kërkesa për strehim por duke qënë se Bashkia Himarë aplikon vetëm programin e restaurimit të banesave shumë të amortizuara të individëve në nevojë dhe në këtë program janë 15 familje të pastreha.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo

ME DELGIM DHE ME URDHER

ZEVENDESKRYETARI

Pervin Gjiku

